



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.181/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 300.00 (*treqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se aktivistët e tyre kanë vërejtur se me datën 08.10.2017, rreth orës 17:22 nga qendra në rrugën “Fehmi Lladrovci”, në vendin e ndaluar, në trafo elektrike, ishte vendosur postri i kandidatit Xhavit Ukaj nga radhët e subjektit politik LDK.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së, duke pretenduar se subjekti politik në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin e kandidatit në fjalë.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 11.10.2017, subjekti politik LDK thekson se ankesa e subjektit politik LVV është e pa bazuar dhe e paarsyeshme për faktin se, vendosja e një posterit të vetëm në një objekt trafo elektrik nuk do të duhej të përbente shkelje, pasi që vendosja e posterëve në objekte të tilla nuk e dëmton në asnjë mënyrë objektin e as nuk e cenon funksionimin e atij objekti. Ndër të tjera subjekti politik LDK, thekson se në trafo postera të tillë gjdo herë na ka rastisur të gjejmë, prandaj edhe aktivistët tonë mund të jenë në lajthitje duke menduar se vendosja në një objekt të tillë nuk përbënë shkelje të vendosjes së posterit të kandidatit në fjalë në vendin e pa lejuar.

Përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur një foto, me të cilën dëshmohet se e kanë evituar shkeljen e supozuar në vendin e pa lejuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se vendosja e posterit të kandidatit Xhavit Ukaj nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur në vend publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi me këtë gjobë paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr.181/2017 më datë 12.10.2017



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.